

OMK ISHTE SEGMENTI QË I MUNGONTE ORGANIZIMIT NË SHËNDETËSINË KOSOVARE



Imet Rrahmani

Ish - Ministër i Shëndetësisë

Oda e Mjekëve të Kosovës ishte segmenti i munguar i organizimit institucional, struktural dhe profesional në shëndetësinë kosovare. Kështu thotë ish-Ministri i Shëndetësisë Imet Rrahmani. Ai thekson se OMK sot duhet të vazhdojë të zhvillojë relacione të shëndosha me anëtarësinë e vet, për të shtuar besueshmërinë dhe kredibilitetin dhe se e ka detyrim ta mbajmë politikën jashtë organizimit dhe frymës së saj.

Si e vlerësoni zhvillimin e deritanishëm të OMK-së dhe, sipas jush, cilat janë të arriturat e saj?

OMK si institucion shumë vite ishte segmenti i munguar i organizimit institucional, struktural dhe profesional në shëndetësinë kosovare. Prandaj, vet ekzistimi i saj, organizimi i tanishëm dhe funksionimi në rrethanat ashtu çfarë janë, mund të konsiderohet si e arritur. Pastaj, OMK ka organizuar zgjedhjet dhe ka funksionalizuar organet e saja me sukses jo vetëm njëherë, ka krijuar një sistem licencimi dhe ri-licencimi që duhet vlerësuar, pa e harruar edhe angazhimin në adresimin e problemeve të mjekut, brenda kompetencave që i ka.

Cili ka qenë bashkëpunimi midis MSH dhe OMK-së gjatë mandatit tuaj si Ministër?

Stadi i zhvillimit të OMK-së dhe rrethanat në atë periudhë ishin me plot sfida, jo mjaftueshëm të mirëkuptuara, herë - herë edhe me debate shteruese, gjithmonë në funksion të gjetjes së zgjidhjeve më të mira brenda ligjit dhe kompetencave edhe të OMK-së edhe të MSH-së. Mbjaj mend se asnjëherë nuk ka munguar angazhimi nga ana e stafit në Ministri, përfshirë edhe pjesën politike, në krijimin e kushteve që OMK sa më shpejt të bëhet funksionale me kompetenca të plota sipas Ligjit për Odën e Profesionistëve Shëndetësor.

Cilat, sipas jush, janë sfidat me të cilat ballafaqohet sot OMK?

OMK ka kaluar një fazë të funksionimit me përvojë të munguar. Një dukuri që po e rëndon mbarë shoqërinë, largimi i mjekëve në vendet e tjera, duhet të trajtohet me projekt dhe aktivitete shumë specifike dhe konkrete, jo vetëm nga OMK, por edhe nga të gjitha institucionet vendimarrëse në vend. Pastaj, edhe OMK, krahas të tjerëve, do të duhej të ishte katalizator i programeve dhe ndërmarrjeve, i bashkëpunimit me organet e drejtësisë, shoqërinë civile dhe mediat, që të thyhet perceptimi tejet negativ për mjekët, dhe duke kontribuar në kthimin e besimit të ndërsjellë në relacionet mjek-pacient-institucione të shtetit.

Çka do të kishit sugjeruar për zhvillimin e mëtejshëm të Odës dhe cila do të duhej të ishte e ardhmja e saj?

OMK duhet të vazhdojë të zhvillojë relacione të

shëndosha me anëtarësinë e vet në radhë të parë, për të shtuar besueshmërinë dhe për të marr mbështetje, për të t'u shndërruar në institucion kredibil brenda komunitetit të mjekëve dhe në raportet me partner qeveritar dhe profesional. Dhe e fundit, e kemi detyrim ta mbajmë politikën jashtë organizimit dhe frymës së OMK-së.

Korrespondenca:
imettrahmani@hotmail.com